



RAPORT I VITIT 2024 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2024, Ministria e Drejtësisë ka përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative:


- 1.Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
- 2.Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- 3.Projektligji "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale";
- 4.Projektvendim “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”;
- 5.Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;

Realizimi i procesit të konsultimit publik për vitin 2024 është 100%.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e një ligji të gjithëpranuar dhe që reflekton interesin e publikut. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

Fig.1: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2024

Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2024



2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2024

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2024 është 24 akte.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

5 (pesë) akte janë miratuar për vitin 2024, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 19 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3 Sa ligje me raport VNR-je janë konsultuar?

Me raport Vlerësimi të Ndikimit Rregullator janë konsultuar 3 projektligjet e miratuara objekt i konsultimit publik:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”; i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë vitit 2024, është shoqëruar nga raporti përkatës VNR;
- Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është shoqëruar nga raporti përkatës VNR;
- Projektligji " Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", i është nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.1.4 Për sa akte në a) Porgram Analitik, PKIE, Dokumenta strategjik janë përdorur kriteret përjashtuese nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

Janë planifikuar për konsultim publik vetëm projektligjet dhe projektdokumentat strategjikë duke përjashtuar projektvendimet në përputhje kjo me parashikimet e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.790/2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”, për vitin 2024 janë parashikuar të miratohen 16 akte, ku 7 prej tyre përjashtohen nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, pasi konsiderohen si akte administrative individuale dhe akte administrative me karakter normativ. Aktet të cilat janë përjashtuar nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik nuk kanë qenë të parashikuar në PKIE apo të kenë lidhje me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

Fig.2: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2024, sipas përfshirjes në PPAP



2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrare, etj.)?

Aktet e miratuara objekt i konsultimit publik gjatë vitit 2024, janë 3 (tre) projektligje, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale” dhe 2 (dy) projektvendime, konkretisht projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, si dhe projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;

2.2. Metodat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare online të konsultimit publik;
2. Përcjellja e komenteve në rrugë postare dhe nëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për konsultimin publik;
3. Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, si dhe janë zhvilluar takime në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë;


- Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

- Projektligj "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", u konsultua përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik.

- Projektvendim “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, si dhe janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

- Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”, u konsultua në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, janë zhvilluar takime me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe u bë publike nga Ministri i Drejtësisë edhe nëpërmjet medias.

Fig. 3: Metodat e konsultimit publik



2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Në lidhje me aktet të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2024, metodat të cilat kanë gjeneruar numrin më të madh të komenteve kanë qenë takimet e zhvilluara me grupet e interesit, institucionet e ndryshme, komunikimet elektronike, si dhe faqja e zyrtare e Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

- Lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, metodat e konsultimit publik të përdorura kanë qenë si vijon:

- Konsultimi në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 28.08.2023 – 26.09.2023.
- Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

Aktivitetet e realizuara:

Korrik 2023 - identifikimi i grupeve të interesit, përzgjedhja e metodave të konsultimit, nga struktura përgjegjëse për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””.

28.08.2023 – 26.09.2023, publikohet njoftimi paraprak në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike”, ku ftohen grupet e interesit që të paraqesin:

- çdo informacion ose opinion paraprak për çdo çështje apo problematikë me të cilën janë hasur gjatë zbatimit të ligjit për përkthimin zyrtar,
- propozime konkrete për ndryshime në ligj me qëllim adresimin e këtyre çështjeve

- informacione ose opinione të tjera që vlerësojnë se i shërbejnë përmirësimit të ligjit për përkthimin zyrtar dhe rritjes së standardit të shërbimit të ofruar nga përkthyesit zyrtarë.

09.11.2023 – 17.12.2023 Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i nënshtrohet procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrat elektronik për Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike”

Projektligji, relacioni shpjegues, si dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Më datë 27.12.2023 është organizuar takimi konsultativ nga Ministria e Drejtësisë me përkthyes zyrtarë.

- Në lidhje me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” metodat e konsultimit publik të përdorura kanë qenë si vijon:

- Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 15.06.2022 - 13.07.2022 , gjatë së cilës janë përcjellë komente përmes këtij protali.
- Tryezat konsultative me grupet e interesit.

Aktivitetet e realizuara:

Maj 2023 - identifikimi i grupeve të interesit, përzgjedhja e metodave të konsultimit, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit.

Projektligji, relacioni shpjegues, si dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Më datë 12.07.2023 janë organizuar dy takime konsultative nga Ministria e Drejtësisë me përfaqësues nga institucione të administratës publike dhe komuniteti i biznesit.

Shënim: Sqarojmë se për sa i përket përmbajtjes së projektligjit, ne thelb nuk ka ndryshuar nga momenti në të cilin është publikuar për konsultim publik. Ndryshimet që janë realizuar konsistojnë në renditjen e dispozitave dhe në riformulimin e tyre, sa i përket teknikës legislative

- Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, metodat e konsultimit publik të përdorura kanë qenë si vijon:

a. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën **25.01.2023 – 22.2.2023**, por nuk janë përcjellë komente.

-Aktivitetet e realizuara:

Projektligji si dhe relacioni shpjegues janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë.

b. Gjithashtu projektligji ka qënë subjekt edhe i konsultimit të brendshëm, gjatë së cilit është konsultuar me organet e qeverisjes qendrore, fusha e kompetencave të së cilave preket nga ky projektligj

Projektakti është përcjellë pranë institucioneve të interesuara me qëllim konsultimin e tij sa më gjithëpërfshirës si Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të cilat kanë përcjellë vlerësimet e tyre në rrugë zyrtare.

Hartimi i projektligjit është realizuar nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë pas kryerjes së një analize dhe shqyrtimi të detajuar të legjisalcionit në fuqi dhe situatës Projektligji, në zbatim të ligjit nr. 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrat elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”. Lidhur me këtë nismë, në Regjistrat nuk ka pasur asnjë koment.

Gjithashtu, projektligji është përcjellë për vlerësim pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Sugjerimet e tyre janë vlerësuar dhe reflektuar nga Ministria e Drejtësisë. Projektligji është bashkërenduar me të gjithë organet e sipërcituara, duke marrë dakordësi nga të gjithë ata.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike”, metodat e përdorura për konsultim kanë qënë si vijon:

a. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 27 dhjetor 2023 – 23.01.2024, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente..

b. Tryezat konsultative me grupet e interesit.

-Aktivitetet e realizuara:

Draft udhërrëfyese për Funksionimin e Institucioneve Demokratike është publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë.

Ky projektvendim është produkt i GNPIE për hartimin e Udhërrëfyesit për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” hartuar në mbështetje të urdhrit nr.57, datë 24.4.2023, të Kryeministrit, “Për disa shtesa në urdhrin nr.94, datë 20.5.2019 të Kryeministrit”, “Për ngritjen e grupeve ndër institucionale të punës për Integrimin Evropian”.

Ky projektvendim i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi intensiv me të gjithë institucionet kontribuese anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për hartimin e udhërrëfyesit Udhërrëfyesit për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” parashikuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit.

Dokumenti është hartuar pas një analize të akteve ligjore dhe kapaciteteve institucionale të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në kriterin politik kryesisht funksionimin e institucioneve demokratike në vijim të procesit “screening”.

“Udhërrëfyese për Funksionimin e Institucioneve Demokratike” është një dokument politik dhe strategjik i cili paraqet masat kryesore që parashikohen të merren në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit (screening report) për Shqipërinë për sa i përket Kriterit Politik kryesisht Funksionimit të Institucioneve demokratike.

Në përputhje me parashikimet ligjore draft udhërrëfyese për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” është konsultuar dhe me Platformën për Partneritetin për Integrimin Evropian (PPIE) dhe për këtë qëllim janë organizuar disa takime në periudhën Shtator 2023- Janar 2024, ku janë trajtuar tematikat e mëposhtme:

- Konsultimi me shoqërinë civile të udhërrëfyesit mbi Funksionimin e Institucioneve Demokratike.
- Njohja me pritshmëritë e Komisionit Evropian sa i takon plotësimit të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike.
- Ftesë për dhënie kontributi mbi udhërrëfyesit pas publikimit për konsultim publik.
- Informimi i pjesëmarrësve mbi rëndësinë e këtyre dokumentave dhe çfarë përfaqësojnë ato.

Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues nga grupet e interesit dhe përfaqësues nga media.

Një mbledhje PPIE (5 tetor) ku morën pjesë 48 anëtarë

Në PPIE e datës 5 tetor u njoh shoqëria civile draft udhërrëfyesit dhe përditësimet e metodologjisë që po ndjek Komisioni Evropian.

Një mbledhje PPIE (12 dhjetor) ku morën pjesë 48 anëtarë, u diskutua mbi rezultat specifikë tetor-dhjetor 2023 të arritura në PPIE.

Në PPIE 12 dhjetor u njoh shoqëria civile me përditësimet e udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, kryesisht me seksionin që lidhet me shoqërinë civile. Udhërrëfyesi u ripublikua për konsultim publik më 27 dhjetor 2023.

Në datën 11 janar pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë u mbajt takimi i radhës i planifikuar për konsultim me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian. Në takim u diskutua rreth përgatitjes së deritanishme të Shqipërisë për procesin e antarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe sfidat që na presin në të ardhmen. Përgjatë takimit u prezantua Draft Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike ku u diskutua me përfaqësuesit e shoqërisë civile për të gjitha masat e parashikuara në udhërrëfyes. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, bota akademike dhe ekspertë të fushës të cilët pasi ishin njohur me dokumentin shprehën interes, shfaqën sugjerimet e tyre dhe diskutuan në mënyrë aktive. Këto sugjerime ishin shumë të vlefshme dhe do të shqyrtohen me qëllim pasqyrimin në Udhërrëfyes.

Në datën 22 janar u mbajt tryeza e radhës së Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian me temë “Konsultimi i draft Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, me përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të botës akademike, botës së biznesit dhe studentë të fakulteteve të drejtësisë. Në takim u diskutua rreth rolit të shoqërisë civile gjatë procesit të monitorimit të e masave dhe prioritetëve të parashikuara në këtë draft Udhërrëfyes. Gjatë takimit theks i veçantë u vendos në përfshirjen e OSHC-ve gjatë procesit zgjedhor, kryesisht në përmirësimin e cilësisë mediatike dhe mbikëqyrjen e financimeve të partive politike dhe institucioneve mediatike formale apo informale të shtuara në masë vitet e fundit. Anëtarët e Tryezës dhe pjesëmarrësit shtruan pyetje ashtu si për punën e vazhdueshme të OJF-ve në përmirësimin e funksionimit të institucioneve demokratike si dhe në ndërmarrjen e masave konkrete për përfshirjen e tyre në proces.

Duhet saktësuar që udhërrëfyesi vjen si dokument politik në përmbushje dhe adresim të rekomandimeve të evidentuara në raportin e shqyrtimit analitik dërguar Shqipërisë nga Komisioni Evropian në muajin korrik 2023. Synimi kryesor i këtij dokumenti është adresimi i gjetjeve të Komisionit Evropian, adresimi i rekomandimeve të OSBE/ODIHR për sa i përket fushës së zgjedhjeve të lira dhe të ndershme si dhe opinioneve të Komisionit të Venecias dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e zgjedhjeve, funksionimit të parlamentit dhe garantimit të një mjedisi mundësues për shoqërinë civile. Ministria e Drejtësisë bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 57 datë 24.04.2023 “Për disa shtesa në urdhrin nr. 94 datë 20.05.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, pika V.1 vepron si sekretariat teknik i grupit të punës për hartimin e udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike në kuadër të negociatave dhe koordinon punën me institucionet e parashikuara në shtojcën Nr. 2 seksioni i Funksionimit të Institucioneve Demokratike.

- Në lidhje me projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”, metodat e konsultimit të përdorura kanë qenë si vijon:

-Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

a. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” për periudhën 10 shtator 2024-10 tetor 2024, gjatë së cilës janë përcjellë komente.

-Aktivitetet e realizuara:

- Ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për hartimin e “Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”, me urdhrin nr. 20, datë 31 Janar 2024 të Kryeministrit;
- Hartimi i vizionit, misionit dhe objektivave të Strategjisë së Re të Drejtësisë dhe prezantimi në Komitetin e Planifikimit Strategjik;
- Hartimi i Dokumentit Konceptual të Politikës së Strategjisë, i cili u prezantua dhe u konsultua me të gjithë institucionet e përfshira në strategji dhe me shoqërinë civile, si dhe u publikua në faqen zyrtare të MD për komente dhe sugjerime.
- Mbledhjet (takimet teknike me anëtarët) e GNP-së;
- Tryeza konsultimi me institucionet e përfshira në strategji, shoqëria civile si dhe partnerët ndërkombëtar të cilët japin ekspertizën e tyre në fushën e sistemit të drejtësisë, me qëllimi garantimin e një procesi gjithëpërfshirës;
- Dërgimi i draftit të konsoliduar për mendim dhe plotësim tek GNP;
- Dërgimi i draftit për mendim tek Organizatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare;
- Kostimi i Strategjisë;
- Konsultim me Ministrinë e Financave, për aspektet financiare;
- Shpallja për mendim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve ligjore (publikimi i Strategjisë në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga aktorët e interesuar në këtë proces, ku drafti do të qëndrojë i publikuar për 21 ditë kalendarike pune);
- Dërgimi i dokumentit tek ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura të drejtësisë për bashkërendim;
- Dërgimi i paketës së SND 2024 - 2030 për miratim me VKM.

Janë zhvilluar gjithsej 10 takime

25.02.2024 Takim konsultativ lidhur me institucionet ligjzbatuese, për prezantimin e draft Raportit Vjetor të Monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, për periudhën janar-dhjetor, ku pas miratimit nga institucionet zbatuese, u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

27.03.2024 Takim i parë me GNP konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe prezantimi i Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës. Në këtë takim morën pjesë: Drejtuesi i Integritetit Evropian, institucionet e pavarura të drejtësisë, trupa diplomatike dhe institucionet e tjera.

28.05.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u diskutuan masat, aktivitetet, treguesit. Në këtë takim, morën pjesë: përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit.

04.06.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u diskutuan masat, aktivitetet, treguesit dhe afatet. Në këtë takim morën pjesë: përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, GJKKO, BKH dhe ILDKPI.

06.06.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u diskutuan masat, aktivitetet, treguesit dhe afatet. Në këtë takim morën pjesë: përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës,

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit.

24.06.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u diskutua lidhur me sfidat dhe përmbushjen e objektivave të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës. Në këtë takim morën pjesë: përfaqësues nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

27.06.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u diskutua lidhur me masat, aktivitetet dhe afatet kohore. Në këtë takim morën pjesë: përfaqësues nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

2.10.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u prezantuan qëllimet kryesore të politikës së strategjisë së re. Në këtë takim morën pjesë: anëtarët e platformës së partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” të cilët janë pjesë e shoqërisë civile.

14.10.2024 Takim konsultativ në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u prezantuan qëllimet e politikës dhe objektivat e strategjisë së re. Në këtë takim morën pjesë donatorët.

18.10.2024 Takim teknik në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, ku u reflektuan komentet e institucioneve të pavarura të drejtësisë. Në këtë takim morën pjesë KLP, PP, ILD.

2.2.3 A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Sa i përket akteve të cilave i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2024, nuk janë zhvilluar konsultime paraprake, përveç njoftimit paraprak të realizuar **në lidhje me projektligjin mbi ndryshimet në ligjin nr.82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”**.

Në lidhje me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, projektakti, relacioni shpjegues, si dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet adresës së e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Më datë 12.07.2023 janë organizuar dy takime konsultative nga Ministria e Drejtësisë me përfaqësues nga institucione të administratës publike dhe komuniteti i biznesit.

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, projektakti si dhe relacioni shpjegues janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar

Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike”, Draft udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike është publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Mbledhjet e kontributeve në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030”, SND III, adreson rekomandimet e Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore/ Nënkapitulli: Të drejtat themelore. SND 2024 – 2030 lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 (PKIE), lidhur me angazhimet në kuadër të Udhërrëfyesit për grupkapitullin 1 “Themelorët” (“Shteti i së Drejtës”). Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026 përfshin masa ligjore, masa institucionale, administrative, masa zbatuese që parashikohen të shtrihen deri në vitin 2026, me objektiva të synuara që lidhen me përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së, dhe forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e tij.

SND III dhe dokumentat e saj strategjik janë përgatitur në përputhje me frymën e parimeve kushtetuese, konventave ndërkombëtare, kornizës ligjore dhe institucionale të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe kuadrit ligjor për sistemin e drejtësisë, sipas standardeve të kërkuara evropiane. Rrjedhimisht, gjatë procesit të hartimit të tyre, i është nënshtruar në mënyrë të vazhdueshme proceseve të konsultimit të hapur me qëllim bërjen e tij sa më transparente dhe gjithëpërfshirës, duke synuar përgatitjen e këtij dokumenti sa më cilësorë dhe në përputhje me realitetin.

Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse (OJF), partnerë kombëtarë/ndërkombëtar, akademikë/studiuues ka dhënë frytet e veta në hartimin e këtij dokumenti. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e Planit të Veprimit dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij.

Grupet e synuara: Institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë; Të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e çështjeve të caktuara të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030; Institucione të tjera të pavarura; Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë; Organizatat e Shoqërisë Civile; Media; Akademia; Organizatat ndërkombëtare të interesuara dhe që kanë në prioritet mbështetjen (edhe financiare) të çështjeve të lidhen me sistemin e drejtësisë.

2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Konsultimi publik ka qenë i hapur për 20 ditët e kërkuara për 5 aktet të cilat i janë nënshtruar këtij procesi gjatë vitit 2024.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””¹

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për këtë projektligj u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 09.11.2023-07.12.2023.

- Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”²

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për projektligjin u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 15.06.2022 - 13.07.2022.

- Projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”³

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për këtë projektligj u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 25.01.2023 – 22.2.2023.

- Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike”⁴

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit. Konsultimi elektronik për këtë projektligj u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 27.12.2023-23.01.2024.

- Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030”⁵

Në kuadër të transparencës dhe ligjit për konsultimin publik, paketa iu nënshtrua procesit të konsultimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga aktorët e interesuar në këtë process. Draft Strategjia publikuar për 20 ditë pune, nga data 10.09.2024-10.10.2024. Për konsultimin e paketës është ndjekur dhe rruga elektronike, si dhe publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të një procesi gjithëpërfshirës.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 7 (shtatë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për

¹ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/677>

² <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/472>

³ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/599>

⁴ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/692>

⁵ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/780>

identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për projektaktin.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur një përmirësim relativisht të dukshëm të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik rezulton të jetë në ngritje. Një nga proceset që mund të përdoret me qëllim përmirësimin e kësaj situatë është zhvillimi sesioneve të ndryshme njohëse me portalin e RENJK me aktorë të ndryshëm.

Gjatë vitit 2024, Ministria e Drejtësisë rezulton me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik 100 %, por jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo vitet paraardhëse.

Të dhënat e përftuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se është rritur numri i vizitorëve përkatësisht 6109 për vitin 2024, ndërsa gjatë vitit 2023 numri ka qenë 5225. Gjatë vitit 2024 vihet re një interes më i lartë në lidhje me komentet e përcjella përmes platformës së regjistrimit elektronik.




Fig 4: Krahasim i numrit të vizitorëve të RENJK përgjatë vitit 2024 dhe 2023

2.4. Palët e interesit të përfshira

2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve gjatë vitit? Sa eksperte ishin në tryeza?

Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë kanë kontribuar në konsultimin e hershëm të akteve që në fazën e draftimit. Numri i ekspertëve të cilët kanë dhënë kontributet e tyre gjatë vitit 2024 ka qenë 34.

Gjatë hartimit të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, palët e interesit të cilat kanë qenë pjesëmarrës me qëllim përcjelljen e kontributeve të tyre, ishin përfaqësues nga Shoqëria Civile, Institucionet e pavarura, Institucionet shtetërore, Partneret për Zhvillim dhe KE.

Më tej, është vijuar me hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore, si dhe në përputhje me komentet e përcjella nga Komisioni Evropian

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, është përcjellë pranë institucioneve të interesuara me qëllim konsultimin e tij sa më gjithëpërfshirës si Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të cilat kanë përcjellë vlerësimet e tyre në rrugë zyrtare. Hartimi i projektligjit është realizuar nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë pas kryerjes së një analize dhe shqyrtimi të detajuar të legjislacionit në fuqi dhe situatës

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””, hartimi i projektligjit ka nisur me publikimin e njoftimit paraprak, në vijim të problematikave të identifikuara nga struktura teknike në Ministrinë e Drejtësisë. Më tej, është vijuar me hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, në përputhje me parashikimet ligjore draft udhërrëfyesi për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” është konsultuar dhe me Platformën për Partneritetin për Integrimin Evropian (PPIE) dhe për këtë qëllim janë organizuar disa takime në periudhën Shtator 2023- Janar 2024, ku janë trajtuar tematikat si konsultimi me shoqërinë civile të udhërrëfyesit mbi Funksionimin e Institucioneve Demokratike, njohja me pritshmëritë e Komisionit Evropian sa i takon plotësimit të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike, informimin e pjesëmarrësve mbi rëndësinë e këtyre dokumentave dhe çfarë përfaqësojnë ato. Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues nga grupet e interesit dhe përfaqësues nga media.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 – 2030”, SND III dhe dokumentat e saj strategjik janë përgatitur në përputhje me frymën e parimeve kushtetuese, konventave ndërkombëtare, kornizës ligjore dhe institucionale të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe kuadrit ligjor për sistemin e drejtësisë, sipas standardeve të kërkuara evropiane. Rrjedhimisht, gjatë procesit të hartimit të

tyre, i është nënshtruar në mënyrë të vazhdueshme proceseve të konsultimit të hapur me qëllim bërjen e tij sa më transparente dhe gjithëpërfshirës, duke synuar përgatitjen e këtij dokumenti sa më cilësorë dhe në përputhje me realitetin.

Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse (OJF), partnerë kombëtarë/ndërkombëtar, akademikë/studiuues ka dhënë frytet e veta në hartimin e këtij dokumenti. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e Planit të Veprimit dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij.

Grupet e synuara: Institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë; Të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e çështjeve të caktuara të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030; Institucione të tjera të pavarura; Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë; Organizatat e Shoqërisë Civile; Media; Akademia; Organizatat ndërkombëtare të interesuara dhe që kanë në prioritet mbështetjen (edhe financiare) të çështjeve të lidhen me sistemin e drejtësisë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Në lidhje me strukturën e anëtarëve të jashtëm të cilët kanë marrë pjesë në draftimin e akteve të konsultuara, konkretisht 34 prej tyre kanë qënë kryesisht institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, media, akademia, organizatat ndërkombëtare të interesuara dhe që kanë në prioritet mbështetjen (edhe financiare) të çështjeve të lidhen me sistemin e drejtësisë.

Për konsultimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, janë organizuar dy takime konsultative nga Ministria e Drejtësisë me përfaqësues nga institucione të administratës publike dhe komuniteti i biznesit, në vijim të të cilit 10 subjekte kanë përcjellë propozimet e tyre.

Për konsultimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””, procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore. Në vijim të takimit konsultativ të realizuar, 5 subjekte kanë përcjellë propozimet e tyre.

Për projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, nuk janë zhvilluar tryeza konsultimi me ekspertë të jashtëm, kompani, etj.

Në lidhje me projektvendimin “Për Udhërrëfyesin për Funksonimin e Institucioneve Demokratike“, janë zhvilluar tryeza konsultimi me të gjitha grupet e interesit si me organizata jofitimprurëse (OJF), partnerë kombëtarë/ndërkombëtar, akademikë/studiuues, ku 8 subjekte kanë përcjellë propozimet e tyre.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030”, janë zhvilluar tryeza konsultimi me të gjitha grupet e interesit si me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, Dhomën Kombëtare të Noterisë. Procesi i

hartimit është mbështetur me ekspertizën e misionit JustAl, dhe OSCE, përmes një grupi ekspertësh të cilët lehtësuan punën e GNP në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri tek kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve. Gjithashtu, janë konsultuar dhe marrë mendime nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women), European Movement Albania (EMA), Prezenca e OSBE-së në Shqipëri...etj. Në vijim të takimeve të organizuara, 11 subjekte kanë përcjellë propozimet e tyre.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit publik përveç institucioneve të cilët kanë qenë të përfshirë në të, pjesëmarrës rezultojnë 114 subjekte, ndërkohë që kanë dhënë komente dhe kontribute 70 prej tyre, ku përfshihen dhe ekspertë të ndryshëm. Informacioni i grupuar për secilin prej projektakteve të konsultuara është paraqitur në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””, ka nisur me publikimin e njoftimit paraprak, në vijim të problematikave të identifikuara nga struktura teknike në Ministrinë e Drejtësisë. Më tej, është vijuar me hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legjislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore.

Në përfundim të këtij procesi projektligji i është nënshtruar publikimit për herë të dytë për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe dërgimit për mendim disa institucioneve. Gjatë zhvillimit të takimeve të realizuara, 4 subjekte të cilët janë përkthyes zyrtarë, kanë paraqitur komentet e tyre.

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, është përcjellë pranë institucioneve të interesuara me qëllim konsultimin e tij sa më gjithëpërfshirës si Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Në lidhje me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, hartimi i tij ka nisur pas përcjelljes së draftit të projektligjit në Ministrinë e Drejtësisë nga ana e Zyrës së Komisionerit. Më tej, është vijuar me hartimin e projektligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e teknikës legjislative. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik, përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore, si dhe në përputhje me komentet e përcjella nga Komisioni Evropian.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike“, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi intensiv me të gjithë institucionet kontribuese anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për hartimin e udhërrëfyesit Udhërrëfyesit për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” parashikuar në Urdhrin nr. 57 datë 24.04.2023 të Kryeministrit. Dokumenti është hartuar pas një analize të akteve ligjore dhe kapaciteteve institucionale të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në kriterin politik kryesisht funksionimin e institucioneve demokratike në vijim të procesit “screening”. Në përputhje me parashikimet ligjore draft udhërrëfyesi për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” është konsultuar dhe me Platformën për Partneritetin për Integrimin Evropian (PPIE) dhe për këtë qëllim janë organizuar disa takime, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues nga grupet e interesit dhe përfaqësues nga media.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 – 2030”, palët e interesuara janë institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e çështjeve të caktuara të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030; Institucione të tjera të pavarura; Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë; Organizatat e Shoqërisë Civile; Media; Akademia; Organizatat ndërkombëtare të interesuara dhe që kanë në prioritet mbështetjen (edhe financiare) të çështjeve të lidhen me sistemin e drejtësisë.

NUMRI I KOMENTEVE NË TRYEZAT E KONSULTIMIT PËR SECILIN PROJEKTAKT



2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Në lidhje me aktet të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2024 në total janë përfshirë 70 shoqata të cilat kanë dhënë kontributin e tyre dhe konkretisht:

- Në lidhje me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", 9 palë të interesuara dërguan komente dhe reagime për projektligjin..

- Në lidhje me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, 9 shoqata janë përfshirë në dhënien e komenteve respektive të cilët dërguan 35 komente.

- Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, nuk ka pasur shoqata të cilat mund të përfshiheshin në tryeza apo aktivitete të ngjashme, pasi hartimi i projektligjit është realizuar nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, janë përfshirë 43 aktorë interesi në dhënien e 35 komenteve përkatëse.

- Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030”, janë përfshirë 43 aktorë interesi në dhënien e 78 komenteve përkatëse.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur në përmirësim. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i portalit të Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të dhe dërgimi i komenteve përmes kësaj platforme. Megjithatë, nisur nga verifikimi i realizuar, numri total të vizitorëve për projektaktet gjatë vitit 2024 është 6109. Këto të dhëna janë trajtuar dhe grafikisht përkatësisht në figurën nr.6.

2.5.Rekomandimet dhe komentet e marra

Gjatë vitit 2024 kontributet e mbledhura në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektakteve, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrat elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë.

2.5.1Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Përmes faqes së konsultimit publik nëpërmjet regjistrat elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ka patur komente.

Për sa i përket projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.82/2021 'Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar'”, numri i komenteve të dërguar nëpërmjet tryezave të zhvilluara dhe faqes së konsultimit publik është 8.

Në lidhje me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, numri i komenteve të dërguar përmes tryezave të zhvilluara është 35.

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, numri i komenteve të dërguar në rrugë zyrtare është 7.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, numri i komenteve të dërguara përmes takimeve të zhvilluara, adresës elektronike dhe faqes zyrtare të konsultimit publik është 36.

Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030”, numri i komenteve të dërguara përmes takimeve të zhvilluara, adresës elektronike dhe faqes zyrtare të konsultimit publik është 79.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për të 5 (pesë) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2024 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 165 (njëqind e njëzeteshtatë), prej të cilave:

- 87 janë pranuar plotësisht
- 61 janë refuzuar plotësisht
- 17 janë pranuar pjesërisht



Fig. : Numri i komenteve të pranuar dhe refuzuara

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të komenteve të përcjella nga qytetarët përmes kësaj platforme.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

2.6.Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe publikuar publikuar në portalin e regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin e konsultimit për 5 nga projektaktet konkretisht:

1. Raport konsultimi për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
2. Raport konsultimi për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
3. Raport konsultimi për projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”;
4. Raport konsultimi për projektvendimin “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”;
5. Raport konsultimi për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së treguesve”;

2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?

Për vitin 2024 Ministria e Drejtësisë ka hartuar raporte konsultimi për të gjitha projektaktet për të cilat ishte planifikuar procesi i konsultimit publik, ku 5 (pesë) prej tyre janë publikuar në portalin e regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK).

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” 8;
- Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” 8;
- Projektligji " Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale " 8;
- Projektvendim “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike” 8;
- Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve 8.

Institucioni vlerëson se konsultimi i këtyre projektakteve ka qenë në nivel shumë të mirë. Për këto projektakte janë përdorur dy metoda të konsultimit publik përkatësisht, publikimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, tryezave të ndryshme me grupet e interesit apo dhe bashkërendimet me institucionet përkatëse nëpërmjet rrugës postare.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Drejtësisë, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.